

ÇMIMI PËR PJESËMARRJE RINORE THIRRJE PËR NOMINIME

I. RRETH ÇMIMIT

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë (MPSDR) në bashkëpunim me Këshillin Rinor Nacional (KRNM) dhe Misionin e OSBE-së në Shkup, ndajnë Çmimin për pjesëmarrje rinore të këtij viti. Çmimi jepet në tri kategori: kategori individuale (të rinjtë e moshës 15-29 vjeç); kategori për grupe rinore joformale (me së paku 3 anëtarë); dhe kategori për organizata rinore, organizata për të rinj dhe organizata rinore ombrellë. Çmimi synon të njohë dhe të vlerësojë punën e të rinjve në adresimin e çështjeve të ndryshme sociale.

Çmimi për pjesëmarrje rinore u jepet iniciativave të të rinjve, grupeve joformale rinore, organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe organizatave ombrellë rinore, të cilat demonstrojnë pjesëmarrje aktive të të rinjve, ndikim shoqëror dhe qëndrueshmëri. Çmimi vlerëson iniciativa që sjellin rezultate të matshme në përmirësimin e komunitetit dhe mirëqenies së shoqërisë.

Kategoria individuale për vitin 2026 i kushtohet temës "Të rinjtë dhe siguria" dhe do të vlerësojë të rinjtë të cilët, përmes aktiviteteve dhe iniciativave të tyre, kanë kontribuar në ndërtimin e paqes, kohezionin social, dialogun ndërkulturor, parandalimin e dhunës tek të rinjtë, , parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe promovimin e jo-dhunës, tolerancës dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve në proceset që lidhen me paqen dhe sigurinë.

Në kuadër të kësaj kategorie do të shqyrtohen ekskluzivisht nominimet që lidhen me aktivitete, iniciativa ose kontribute nga fusha "Të rinjtë dhe siguria", të realizuara nga personi i nominuar.

II. KATEGORITË E ÇMIMEVE

Do të jepen tre (3) çmime, një për secilën kategori të mëposhtme:

1. **KATEGORIA INDIVIDUALE "TË RINJTË DHE SIGURIA" (PËR TË RINJ TË MOSHËS 15 DERI NË 29 VJEÇ)**
2. **KATEGORIA E GRUPEVE JOFORMALE TË TË RINJVE (ME TË PAKTËN 3 ANËTARË)**
3. **KATEGORIA E ORGANIZATAVE RINORE, ORGANIZATAVE PËR TË RINJ DHE ORGANIZATAVE OMBRELLË RINORE**

III. KUSHTET PËR NOMINIM

Të rinjtë e nominuar në kategorinë individuale dhe anëtarët e grupit joformal të të rinjve të nominuar për Çmimin për pjesëmarrjen rinore duhet t'i plotësojnë këta kushte:

- Të jenë **shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut**;
- Të jenë të **moshës 15 deri në 29** vjeç deri në datën e paraqitjes së aplikimit;
- Të kenë implementuar aktivitetin, punën ose shërbimet për të cilat janë nominuar në **territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut**;
- Të kenë implementuar aktivitetin, punën ose shërbimet për të cilat janë nominuar në periudhën **qershor 2025 – maj 2026**;
- Të dëshmojnë se kanë pasur **rol kryesor** në aktivitetin për të cilin janë nominuar.

Për kategorinë individuale do të shqyrtohen ekskluzivisht nominimet që lidhen me aktivitete dhe iniciativa nga fusha "Të rinjtë dhe siguria".

Organizatata rinore, organizatat për të rinj dhe organizatat ombrellë rinore të nominuara për Çmimin për pjesëmarrjen rinore duhet t'i plotësojnë këta kushte:

- Të jetë shoqatë ose fondacion i regjistruar **në Republikën e Maqedonisë së Veriut** në përputhje me Ligjin për shoqata dhe fondacione;
- Të jenë të regjistruara si një nga format e organizimit rinor në Regjistrin e formave të organizimit rinor të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, në përputhje me Ligjin për Pjesëmarrjen Rinore dhe Politikën Rinore.
- Të kenë të paktën **dy vjet ekzistencë aktive**;

Nëpunësit shtetërorë, personat e emëruar politikisht, personeli i ndërmarrjeve publike dhe/ose udhëheqësit e partive politike nuk mund të nominohen për Çmimin për pjesëmarrje rinore.

IV. KRITERET E NOMINIMIT

Kandidatët idealë për Çmimin për pjesëmarrje rinore:

- Demonstrjnë përkushtim të jashtëzakonshëm dhe kontribut në përmirësimin e jetës në shoqëri;
- Tregojnë pjesëmarrje të fuqishme rinore, lidhshmëri dhe përfshirje aktive të të rinjve në zbatimin e aktivitetit;
- Kanë ndikim të dukshëm në politikën rinore dhe ndryshimet në nivel lokal dhe/ose kombëtar;
- Zbatojnë zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme për sfidat shoqërore;
- Tregojnë se iniciativa mund të rritet dhe të përsëritet në mjedise të ndryshme;

- Janë të njohur mes bashkëmoshatarëve dhe në komunitetin më të gjerë;
- Aplikojnë qasje kreative dhe inovative për përfshirjen e komunitetit në zgjidhjen e çështjeve shoqërore;
- Zhvillojnë ose mbështesin mundësi për të rinjtë që të marrin pjesë në aktivitete që kanë kontribut pozitiv në shoqëri dhe në zhvillimin e tyre;
- Përfshijnë persona në rrezik social në përpjekjet për të adresuar çështjet shoqërore;
- Ndërmarrin veprime që sjellin zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme për çështjet sociale;

Për kategorinë individuale "Të rinjtë dhe siguria", do të zbatohen kriteret e përcaktuara për këtë kategori, me fokus në kontributin në fushën e paqes, sigurisë dhe kohezionit shoqëror, duke përfshirë:

- promovimin e paqes dhe tolerancës, mospërdorimi i dhunës;
- aktivitete që lidhen me parandalimin e dhunës të të rinjtë;
- iniciativa për avokim ose aktivitete për promovimin e agjendës për të rinjtë, paqen dhe sigurinë (YPS);
- dialog ndërkulturor, ndëretnik dhe ndër-gjenerativ;
- ndërtimin e kohezionit social dhe besimit në komunitetet;
- mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut;
- parandalimin e diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, narrativave negative dhe ekstremizmit të dhunshëm;
- pjesëmarrjen aktive të të rinjve në iniciativa që lidhen me paqen dhe sigurinë.

Nuk do të shqyrtohen nominimet për aktivitete të realizuara nga individë ose grupe që përfshijnë:

- Mbështetje ose lobim në emër të një partie politike;
- Aktivitete fetare;
- Hulumtime akademike ose punë për zhvillim profesional personal.

V. ÇMIMI

Qëllimi i çmimit është të njohë dhe vlerësojë punën e të rinjve në adresimin e çështjeve të ndryshme shoqërore, ndërsa mbështetja financiare do të sigurojë avancimin e punës dhe aktivizmit të fituesit. Çmimi për pjesëmarrje rinore sipas kategorive është si më poshtë:

- 1,500 EUR për kategorinë individuale "Të rinjtë dhe siguria";
- 3,000 EUR për grupet joformale të të rinjve dhe
- 3,000 EUR për organizatat rinore.

VI. UDHËZIME PËR PARAQITJEN E NOMINIMIT

Nominimet për secilën nga kategoritë mund të dorëzohen nga persona individualë, organizata, institucione, sektori mediatik, sektori i biznesit ose anëtarë të tjerë të komuniteteve. Çmimet do t'i prezantohen publikut të gjerë në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë (12 gusht 2026) në Shkup.

Mund të dorëzoni nominimin Tuaj në linkun e mëposhtëm:

➤ **NOMINIM PËR ÇMIMIN PËR PJESËMARRJE RINORE 2026**

Afati i fundit për dorëzimin e nominimeve është **data 7 korrik 2026, ora 23:59**.

VII. KRITERET DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT

Pas përfundimit të procesit të dorëzimit të nominimeve, të gjitha aplikimet do të shqyrtohen sipas kriterëve teknike, me qëllim përcaktimin nëse i plotësojnë kushtet bazë për shqyrtim të mëtejshëm. Ky rishikim do të përfshijë verifikimin nëse i nominuari është në moshën 15 deri 29 vjeç, nëse aktiviteti është realizuar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe nëse është zbatuar në periudhën nga qershori i vitit 2005 – maj 2026.

Nominimet që kalojnë me sukses verifikimin teknik do të shqyrtohen në detaje nga një komision vlerësimi, i cili do të përzgjedhë deri në tre kandidatë për secilën kategori për fazën e mëtejshme të votimit publik online. Komisioni do t'i vlerësojë nominimet sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht, të ndara në katër kategori:

Kategoria	Kriteri	Gjithsej pikë
1. Pjesëmarrje rinore (maksimumi 40 pikë) * për të gjitha kategoritë	Lidership	15
	Përfshirja e të rinjve në zbatim	15
	Diversiteti (përfshirja e grupeve të ndryshme, përfaqësimi gjinor, etj.)	10
2. Ndikimi (maksimumi 30 pikë) * për grupet informale dhe organizatat rinore (kategoria 2 dhe 3)	Mbështet të rinjtë nga komunitetet e marginalizuara/grupet specifike të synuara	10
	Ndikimi mbi politikat rinore (lokale/kombëtare)	10
	Angazhimi qytetar dhe ndikimi social	10

2. Ndikimi (maksimumi 30 pikë) * për kategorinë individuale "Të rinjtë dhe siguria"	Kontribuon në rritjen e besimit midis komuniteteve të ndryshme dhe në ndërtimin e kohezionit shoqëror, si dhe në parandalimin e dhunës tek të rinjtë	10
	Krijon hapësirë për dialog ndërkulturor, ndëretnik ose ndër-gjeneracional	10
	Ndërtimi i paqes dhe promovimi i tolerancës dhe jo-dhunës	10
3. Qëndrueshmëria dhe bashkëpunimi (maksimumi 20 pikë) * për të gjitha kategoritë	Ndërmarrin veprime që sjellin zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme për çështjet sociale	10
	Bashkëpunimi me palët e tjera të interesit	5
	Potencial për rritje dhe riprodhueshmëri të iniciativës/aktiviteteve	5
4. Inovacioni (maksimumi 10 pikë) * për të gjitha kategoritë	Qasje kreative dhe inovative për zgjidhjen e çështjeve shoqërore	5
	Qasje kreative dhe inovative për përfshirjen e të rinjve	5
Gjithsej pikë		100

***SHËNIM METODOLOGJIK PËR VLERËSIMIN PËR KATEGORINË INDIVIDUALE "TË RINJTË DHE SIGURIA",**

Gjatë vlerësimit të nominimeve në kategorinë individuale "Të rinjtë dhe siguria", në lidhje me pjesëmarrjen rinore, qëndrueshmërinë dhe bashkëpunimin dhe inovacionin, komisioni zbaton të njëjtat kritere të pikëzimit si për kategoritë e tjera, me fokus shtesë në vlerësimin cilësor të kontributit në fushën e paqes, sigurisë dhe kohezionit shoqëror.

Në lidhje me ndikimin, në kategorinë individuale janë përfshirë kritere që i japin peshë më të madhe vlerësimit të aktiviteteve që demonstrojnë kontribut real dhe të drejtpërdrejtë në: ndërtimin e komuniteteve paqësore dhe gjithëpërfshirëse, promovimin e tolerancës dhe të drejtave të njeriut, uljen e diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe pjesëmarrjen aktive dhe domethënëse të të rinjve në iniciativa të kësaj fushe.

Komisioni është i detyruar të sigurojë zbatimin e qëndrueshëm të këtyre udhëzimeve gjatë vlerësimit të të gjitha nominimeve në këtë kategori.

VIII. KORNIZA KOHORE

THIRRJE PËR NOMINIME PËR ÇMIMIN PËR PJESËMARRJE RINORE	23 QERSHOR 2026
AFATI I FUNDIT PËR DORËZIMIN E NOMINIMEVE	7 KORRIK 2026
SHQYRTIMI I NOMINIMEVE DHE PËRZGJEDHJA E NJË RRETHI MË TË NGUSHTË	8-10 KORRIK 2026
PROCESI I VOTIMIT PUBLIK ONLINE	15 KORRIK – 05 GUSHT 2026
NJOFTIMI I FITUESVE	5-10 GUSHT 2026
NGJARJA PËR NDARJEN E ÇMIMEVE PËR PJESËMARRJE RINORE	12 GUSHT 2026

* Datat e mësipërme janë subjekt ndryshimi